



Biografi e shkurtër

Eni Karagozi u diplomua në vitin 2007 në degën Administrim - Biznes në fakultetin Ekonomik, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2011 përfundon studimet Master në Administrim Biznes (MBA), Sipërmarrje, në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit të Tiranës.

Ka një përvojë pune në sektorin financiar për rreth 12 vjet, në banka të nivelit të dytë si banka NBG Albania SHA dhe American Bank of Investment (ABI Bank). Gjatë vitit të fundit të studimeve universitare u punësua me kohë të pjesshme në NBG Bank, si analiste e kredive individuale për t'u punësuar më tej, me kohë të plotë, në po të njëjtin vit. Ka punuar në këtë pozicion deri në prill 2009, më pas, si analiste e kredive të biznesit e më tej, si menaxhere për marrëdhëniet me biznesin e mesëm deri në maj 2012.

Në maj 2012 u emërua si menaxhere për marrëdhëniet me bizneset e mëdha vendase dhe ato të huaja në divizionin e korporatave. Nga janar 2013 - shkurt 2014 ka punuar si menaxhere e portofolit të bizneseve të mëdha vendase dhe ato të huaja në divizionin e korporatave.

Deri në tetor 2014 ishte emëruar drejtuese e departamentit të analizës të kredive të biznesit të mesëm dhe korporatë. Prej muajit tetor 2014 - dhjetor 2018 ka qënë drejtuese e divizionit të klientëve korporatë.

Gjatë vitit shkollor 2007 – 2008 ka qënë pedagoge e jashtme në lëndën "Burime Njerëzore" në departamentin e Manaxhimit, në Fakultetin Ekonomik, pranë Universitetit të Tiranës.

Gjatë eksperiencës së saj të punës ka kryer një sërë trajnimesh me ekspertë vendas dhe të huaj për konsulencë biznesi, analizë kredie hipotekore, financimin e tregtisë ndërkombëtare dhe menaxhimin e riskut në kredidhënie. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

Aktualisht, është pjesë e strukturës së Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me detyrën këshilltare ekonomike.